



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE**

NJOFTIM

**“PËR
FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE
JOMAGJISTRATË PËR POZICIONIN E INSPEKTORIT PRANË ZYRËS SË
INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 209 dhe nenit 211, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të pikave 3 dhe 77, të vendimit nr. 536, datë 25.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit”, urdhrin nr. 7, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për miratimin e Rregullores “Për procedurën dhe kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të urdhrin nr. 88, datë 29.06.2026 “Për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përfundim të afatit të dorëzimit të dokumentacionit për shprehje interesi për pozicionin “Inspektor Jomagjistrat”, pranë Njesisë së Inspektorëve, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komiteti i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, ka vendosur fillimin e procedurës përzgjedhëse të kandidatëve jomagjistratë që kanë shprehur interes për pozicionin e inspektorit, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1. Jurida Bajraktari | 10. Eltiona Metani |
| 2. Julis Zebi | 11. Olsa Nikolla |
| 3. Loreta Jashari | 12. Amarilda Xhyheri |
| 4. Ermir Mema | 13. Ervin Aliu |
| 5. Majlinda Miska | 14. Lajda Bana |
| 6. Klemend Kajana | 15. Evis Fico |
| 7. Rezarta Taushani | 16. Enio Haxhimihali |
| 8. Gentiana Agushi | 17. Vildan Kaloshi |
| 9. Dorina Dervishaj | 18. Eglantina Bakiu |

Për të vijuar me kryerjen e procedurave dhe veprimeve ligjore të përzgjedhjes së kandidatëve, secili kandidat ka detyrimin për t'u paraqitur pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, nga dita e njoftimit të tij në mënyrë individuale.

KOMITETI I EMËRIMIT DHE VLERËSIMIT TË INSPEKTORËVE